

UDHËZIMET E SUREVE TË KUR'ANIT

esSebil

Titulli i origjinalit

هدايات الأجزاء

Komisioni Shkencor pranë

Organit Botëror për Meditimin e Kur'anit Fisnik

“Tedebbur-Meditim”

Nën përkujdesjen dhe mbikëqyrjen e

Dr. Umer MUKBIL

Përshtati:

Xheladin LEKA

Lektor:

Mr. Arjan KOÇI

Botues:

ESSEBIL

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara: asnjë pjesë e këtij publikimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem, të transmetohet në ndonjë formë, kuptim, në mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjim, përkthim apo shkrim pa lejen e botuesit.

Udhëzimet e sureve të Kur'anit

Përmbajtja

Përmbajtja.....	5
Fjala e përkthyesit	7
Hyrje.....	11
Surja Fatiha.....	13
Xhuzi i parë.....	13
Xhuzi i dytë	15
Xhuzi i tretë	16
Xhuzi i katërt.....	17
Xhuzi i pestë	19
Xhuzi i gjashtë.....	22
Xhuzi i shtatë	24
Xhuzi i tetë.....	26
Xhuzi i nëntë.....	28
Xhuzi i dhjetë.....	30
Xhuzi i njëmbëdhjetë	33
Xhuzi i dymbëdhjetë	35

UDHËZIMET ...

Xhuzi i trembëdhjetë.....	38
Xhuzi i katërbëdhjetë	40
Xhuzi i pesëmbëdhjetë.....	42
Xhuzi i shtatëmbëdhjetë	48
Xhuzi i tetëmbëdhjetë.....	50
Xhuzi i njëzetë.....	57
Xhuzi i njëzetënjëtë.....	60
Xhuzi i njëzetedytë.....	64
Xhuzi i njëzetetretë	67
Xhuzi i njëzetekatërtë	70
Xhuzi i njëzetepestë	73
Xhuzi i njëzetegjashtë	76
Xhuzi i njëzeteshtatë.....	81
Xhuzi i njëzetetetë	86
Xhuzi i njëzetëntë	90
Xhuzi i tridhjetë	93

Fjala e përkthyesit

Falënderimi i takon Allahut të Madhëruar, kurse paqja dhe përshëndetjet nga zemra i takojnë të dashurit të Tij dhe të dashurit tonë, Muhamedit sal-Allahü alejhi ve sel-lem, familjes dhe të gjithë shokëve të tij.

Ky është një libërth i vogël për nga madhësia, i shkurtër në fjalë, por që përmban në vetvete një projekt madhështor për të cilin ka nevojë çdo musliman, nga muslimani i rëndomtë deri tek hoxha i mirëfilltë.

Madje mund të them se kjo nevojë për muslimanin është e përjetshme, ngase kuptimi i drejtë i Kuranit, meditimi i tij dhe veprimi me të është edhe qëllimi kryesor i zbritjes së këtij libri të shenjtë.

Për të përfituar nga ky projekt ashtu siç kërkohet, mendoj se duhet ndjekur njëra nga këto dy metoda:

E para: Të komentohet Kur'ani nga hoxhallarët në bazë të këtij projekti, pra, duke lexuar udhëzimet e sur-

eve një nga një dhe pastaj komenti i tyre vjen në formë të shkurtër, në mënyrë që xhemati ta kuptojë qëllimin e ajeteve, duke mos i futur në detaje dhe degëzime.

E dyta: Të lexohen këto udhëzime duke pasur Kur'anin pranë vetes, në mënyrë që për çdo pikë të shënuar në këtë libërth të mundohesh të gjesh vendin e saj në sure dhe kështu të vazhdosh derisa të përfundosh gjithë Kur'anin. S'ka dyshim se nëse ecën deri në fund të Kur'anit në këtë formë, do të kesh një parafytyrim të mirë për gjithë përmbajtjen e tij.

Kush e lexon këtë libërth me meditim, qoftë me ndonjë hoxhë apo edhe vetëm, do të shohë praktikisht ndikimin e Kur'anit tek ai dhe do të bindet se sikur ta kuptonim Kur'anin ashtu siç duhet, nuk do të ngopeshim kurrë me të.

Kur'ani i ngjan një kopshti të madh plot thesare dhe begati, mirëpo për të hyrë në këtë kopsht duhet të kesh çelësin e portës, andaj lus Allahun e Madhëruar të bëjë këtë libërth çelës të kësaj porte të madhe, që past-

aj t'i shijojmë begatitë e këtij kopshti të pafund në këtë botë para botës tjetër.

Allahu jep suksesin dhe vetëm prej Tij kërkujmë bereqetin.

Xheladin LEKA

Mekë, Arabi Saudite

Hyrje

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, përshëndetjet dhe lutjet qofshin për të Dërguarin tonë, Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, për familjen dhe të gjithë shokët e tij.

Këto janë disa shenja të shkurtra dhe ndalesa të shpejta për të sqaruar atë që përmbajnë tridhjetë xhuzet e Kur'anit Fisnik¹. I kemi vendosur këto shenja pranë muslimanëve që t'u shërbejnë si llamba ndriçimi përmes së cilave ata udhëzohen për të kuptuar temat më kryesore që përmbajnë këto xhuze, me shpresë se do të hapin një dritare drejt meditimit të Kur'anit.

E kemi parasysh se shkurtesa në rrëfim është shumë e vështirë, qoftë edhe në fjalët e njerëzve të njohur për oratori, e si është çështja kur flitet për Fjalët e Zotit të

¹ Titulli i libërthit në origjinal është "*Udhëzimet e xhuzeve*", mirëpo pasi mund të mos jetë i qartë për shumë lexues, vendosa të bëj një ndryshim të vogël duke mos u larguar nga përmbajtja e tij (sh.p.).

njerëzve?! Fjalës së Tij nuk i afrohet asgjë, madje vlera e Fjalës së Tij ndaj fjalëve të njerëzve është sikurse vlera e Tij ndaj krijesave të Tij.

Megjithatë këto pak faqe me lejen e Allahut do të jenë si një bërthamë, që në të ardhmen të shkruhet më gjerësisht rreth kësaj teme dhe shpresojmë që kjo gjë të realizohet sa më parë.

Përgatiti: Komisioni Shkencor pranë Organit Botëror për Meditimin e Kur'anit Fisnik "Tedebbur-Meditim"

Nën përkujdesjen dhe mbikëqyrjen e Dr. Umer
MUKBIL

Surja Fatiha

Temat kryesore që trajton surja FATIHA

1. Lavdërimi dhe madhërimi i Allahut.
2. Shfaqja e sinqeritetit në adhurim dhe kërkim të ndihmës dhe se këto të dyja bëhen vetëm për hir të Allahut.
3. Tregimi për udhëzimin dhe për realitetin e tij.
4. Llojet e njerëzve që janë privuar nga udhëzimi.

Xhuzi i parë

- Fillimi i sures Bekare përmend llojet e njerëzve, besimtarë, jobesimtarë dhe hipokritë, por tregimi për hipokritët është më i gjatë.
- Rrëfen për Ademin alejhi selam dhe mëkëmbjen e tij në tokë.

- Fillon tregimin për bijtë e Israilit, sidomos për çifutët, lidhjen e tyre me shpalljen dhe me Pejgamberët të cilët nuk ishin nga bijtë e Israilit.
- Aty është edhe tregimi i lopës, i cili është mesazh për këtë ummet. Rezymeja e këtij mesazhi është rreziku nga lëkundja në pranimin e dispozitave të Allahut dhe kjo gjë është shkak për ngurtësimin e zemrës.
- Pastaj sqarohen me detaje fëlliqësitat e çifutëve ndaj Pejgamberëve të Allahut dhe melaikeve të Tij.
- Rreziku i ndalimit të dhikrit (përmendjes) të Allahut nëpër xhami dhe rreziku i nxitimit për t'i shembur këto xhami.
- Përmendja e xhamisë së shenjtë të Mekës, kush e ka ndërtuar dhe si është ndërtuar.

Xhuzi i dytë

- Përsëritet prapë tregimi për bijtë e Israilit dhe se si ata kritikuan drejtimin e kiblës, pastaj jepet kundërpërgjigjja ndaj tyre si dhe tregohet për vlerën e ummetit islam dhe se ky ummet është ummeti më i mirë.
- Përkujdesja për pastrimin e shpirtit është më primare sesa përkujdesja për drejtimin drejt kiblës, edhe pse ty dyja janë të rëndësishme.
- Obligueshmëria e agjërimit dhe qartësimi i rregullave dhe gjërave të tjera që kanë lidhje me agjërimin. Ky vend në këtë xhuz është vendi i vetëm në Kur'an që flet për agjërimin, andaj meditoni mirë për të.
- Qartësimi i dispozitave të haxhit, por surja në këtë xhuz është përqendruar në qartësimin e dispozitave praktike, ndryshe nga surja El Haxh, ku përqendrimi është në dispozitat e haxhit që kanë lidhje me veprat e zemrës dhe të besimit.

- Rrëfimi i gjerë për shumë dispozita të familjes, sikurse kurorëzimi, shkurorëzimi dhe gjidhënia, pastaj lidhja e tyre me devotshmëri dhe mbikëqyrje të Allahut.
- Përqendrimi në lidhjen mes dispozitave të familjes dhe besimit në Ditën e Kiametit, ngase ky besim ka gjurmë të mëdha për njeriun që ai t'i zbatojë këto dispozita si duhet.
- Në tregimin e Xhalutit është një mësim i madh për durimin, ngase fitorja kundër armiqve nuk është thjesht në numrin e shumtë të ushtarëve.

Xhuzi i tretë

- Në të gjendet ajeti më i madh, Ajetul Kursij, ndaj meditoni për fshehtësinë e madhësisë së këtij ajeti.
- Pas Ajetul Kursij janë përmendur tre tregime, duhet të meditojmë dhe të mendojmë mirë për to.

- Nxitja për hua të mirë dhe për lëmoshë dhe qartësimi se shejtani është ai që e frikëson njeriun për armikun. Medito mirë për këtë ajet: “Ka nga ata ithtarë të librit, që sikur t’u besosh një barrë të tërë ari, do t’jua kthejnë.” (Alu Imran: 75)

Xhuzi i katërt

- Qartësimi për shtëpinë e parë e cila është vendosur për njerëzit (Qabja) dhe qartësimi i njërit nga argumentet për obligueshmërinë e haxhit.
- Rëndësia e kapjes për litarin e Allahut dhe rëndësia e bashkimit dhe mospërçarjes.
- Pozita e urdhërimit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja, saqë është përmendur para besimit në Allahun.
- Rreziku nga shoqëria e keqe.
- Rrëfimi për luftën e Uhudit dhe qartësimi i ndikimit të mëkateve në humbjen e ummetit; rrezi-

ku i mëkateve të mëdha si kamata dhe vrapimi pas dynjasë.

- Përmendja e disa cilësive të robërve të devotshëm të Allahut, medito për këtë dhe mundohu të jesh edhe ti nga këta njerëz.
- Sqarimi i disa gjërave të cilat janë nga kundërthëniet e çifutëve.
- Ajetet e fundit të sures Alu Imran (nga ajeti 190 e deri në fund) kanë vlerë të madhe. Pejgamberi ynë sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i lexonte ato kur zgjohej nga gjumi, andaj ia vlen të meditojmë për këto ajete.
- Surja Nisa, e cila fillon në këtë xhuz, përqendrohet te të drejtat e të dobëtëve: jetimëve, grave, të pamundurve, atyre që nuk kanë pasur mundësi të emigrojnë.
- Allahu i Lartësuar mori përsipër ndarjen dhe caktimin e trashëgimisë, në mënyrë që të ndalë

mosmarrëveshjet mes familjeve, mosmarrëveshje të cilat zakonisht ndodhin për shkak të pasurisë.

- Qartësimi i grave me të cilat është e ndaluar martesat.

Xhuzi i pestë

- Tregimi për raportet familjare, sidomos raportet bashkëshortore, dhe si zgjidhet problemi nëse ndodh dhe gjithashtu shfaqja e parimit të pajtimit dhe përmirësimit mes tyre.
- Profeti ynë sal-lAllahu alejhi ve sel-lem qau kur dëgjoi fjalën e Allahut të Lartësuar: "Si do të bëhet kur prej çdo populli të sjellin dëshmitarë dhe të sjellin ty (o Muhamed!) për dëshmitar mbi të gjithë ata?!" (En-Nisa: 41), po gjendja jonë cila do të jetë?
- Tregimi për falsifikimin që çifutët u bëjnë fakteve, tregimi për gënjeshtren dhe zilinë e tyre, nd-

- aj krahasoje këtë falsifikim me atë që po ndodh sot.
- Rrëfimi për kthimin e amaneteve pronarëve të tyre dhe kujdesi për drejtësi në gjykim ndaj njerëzve.
 - Urdhri për respektimin e Allahut, të Dërguarit të Tij dhe udhëheqësve muslimanë dhe sqarimi se kthimi në rast mosmarrëveshjeje është tek Allahut dhe i Dërguari i Tij.
 - Nga cilësitë e hipokritëve është të gjykuarit tek dikush tjetër dhe jo tek sheriati i Allahut, madje ndalojnë nga sheriati i Allahut me gjithë mundësitë që kanë.
 - Obligueshmëria e dorëzimit ndaj gjykimit të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij sal-Allahu alejhi ve sel-lem.
 - Urdhri për kujdes dhe përgatitje për në rrugën e Allahut (luftë), nëse ekziston shkaku.

- Vënia në pah e rrezikut të shejtanit dhe kujdesi i tij i madh për të na humbur.
- Rreziku i mbytjes së besimtarit pa të drejtë dhe kërcënimi i madh për këtë vepër.
- Shkurtimi i namazit në udhëtim dhe përmendja e një mënyre nga mënyrat e namazit të frikës.
- Përmendja e disa rregullave të sjelljeve bashkëshortore, sikurse nushuzi (mospërfillja e gruas për burrin e saj), drejtësia mes bashkëshorteve, ndarja, të gjitha të shoqëruara me mbikëqyrjen e Allahut.
- Rrëfimi për hipokritët, për miqësinë e tyre me armiqtë e Allahut, si dhe rrëfimi për përtacinë e tyre ndaj adhurimit, pastaj përmendja e vendit të tyre në botën tjetër.

Xhuzi i gjashtë

- Rrëfen për të krishterët dhe çifutët dhe për mend thënie e tyre për Musain alejhi selam si dhe qëndrimin e tyre ndaj Merjemes dhe Isait alejhi selam.
- Pjesa më e madhe e këtij xhuzi i takon sures El-Maide, e cila është nga suret e fundit medinase që janë shpallur. Kjo sure përqendrohet në tregimin e marrëveshjeve dhe besëlidhjeve me të afërmit dhe të largët madje edhe jobesimtarët, në mënyrë që besimtari të edukohet që ta ruajë esencën e plotësimit të detyrimeve dhe marrëveshjeve.
- Kjo sure përmban tetëmbëdhjetë dispozita që nuk gjenden në ndonjë sure tjetër.
- Surja fillon me rrëfimin e zgjeruar për disa ushqime të ndaluara dhe sqaron disa lloje të ushqimit të lejuar.

- Përmendet ajeti i abdestit, pastaj përmenden disa shkaqe të obligueshmërisë së abdestit dhe të obligueshmërisë së guslit.
- Veprimi me dëshminë për hir të Allahut dhe urdhri për drejtësi edhe me ata që urren.
- Njohja me natyrën e lidhjes së të krishterëve dhe çifutëve me Zotin e tyre dhe me Pejgamberët është çështje e rëndësishme për mënyrën e sjelljes me ta.
- Rrëfëhet për thirrjen e Musait alejhi selam për të hyrë në tokën e shenjtë dhe qartësimi i vlerës së thënies së të vërtetës si dhe shpejtimi për t'i nxitur njerëzit të punojnë punë të mira dhe të mbështeten me të vërtetë tek Allahu az-ze ve xhel-leh.
- Jepet rrëfimi për rrezikun e vrasjes pa të drejtë dhe neveria e çrregullimit dhe bërjes së tij dhe

vlera e ngjalljes së shpirtave në formën konkrete dhe abstrakte.

- Përmendet zbritja e librave nga Allahu dhe qartësimi i gjykimit për atë që nuk gjykon me ligjin e Allahut.
- Ndalohet miqësimi me çifutët dhe të krishterët dhe rreziku i heshtjes së dijetarëve ndaj kundërvajtjeve shariatike.
- Përgënjeshtrohet dyshimi i të krishterëve për Profetin e Allahut, Isain alejhi selam, dhe paraqitja e pendimit tek ata pas kësaj.

Xhuzi i shtatë

- Fillon me rrëfimin për më të afërmit dhe më të largët nga të krishterët dhe çifutët për ne.
- Përmenden disa rregulla legjislative, si shpagimi i betimit, ndalimi i alkoolit dhe bixhozit, ndalimi i gjuetisë për haxhiun përderisa është muhr-

im dhe shpagimi për atë që e vepron, testamenti para vdekjes, qartësimi i dëshmitarëve dhe qartësimi i gjykimit nëse nuk gjenden dëshmitarë muslimanë.

- Jepet diskutimi mes Isait alejhi selam dhe ndihmëtarëve të tij (havarijunëve).
- Na bëhet e qartë biseda që ndodhi mes Allahut dhe Isait alejhi selam dhe pafajësia e Isait alejhi selam nga pretendimi i pasuesve të tij se ai është Zot.
- Fillimi i sures El En'am vërteton njëshmërinë, ringjalljen dhe profetësinë.
- Këshillohen ata që i kanë kthyer shpinën argumenteve të Allahut dhe që kanë përgënjeshtuar fenë e vërtetë, pastaj kërcënohen se do t'i godasë dënimi ashtu si njerëzit që jetuan para tyre.
- Tregohet polemika e Ibrahimit alejhi selam me popullin e tij, e cila konsiderohet nga polemikat

më të rëndësishme për vërtetimin e besimit me argumente konkrete.

- Ngulitet besimi përmes meditimit në krijimin dhe universin e Allahut dhe se kjo gjë mbjell respekt dhe madhërim ndaj Allahut.

Xhuzi i tetë

- Qartëson disa çështje legislative që kanë lidhje me besimin. Më të rëndësishmet janë: përmendja e Allahut (thënia bismilah) kur theret kafsha dhe ndalimi i ngrënies së mishit që është prerë pa u përmendur emri i Allahut, sidomos nëse gjatë prerjes në vend të emrit të Allahut është përmendur emri i ndonjë idhulli.
- Lidhja e zemrës me Allahun në rast udhëzimi dhe rast devijimi na bën që çdoherë të kthehemi tek Zoti ynë që të na hapë gjokset me udhëzim nga Ai.

- Sqarohen disa adhurime që shpikën politeistët, për të cilat nuk ka argument nga Allahu, si dhe jepet kundërshtimi ndaj tyre.
- Fundi i sures El En'am përmban dhjetë porosi të ndryshme, ndaj është e rëndësishme t'i kuptojmë, të meditojmë për to dhe të punojmë sipas tyre.
- Surja El A'raf fillon me rrëfimin e bisedës mes shejtanit dhe Zotit dhe pastaj tregon se si shejtani ka mashtruar Ademin dhe gruan e tij. Por, a thua po marrim mësim nga ky mashtrim i shejtanit?
- Pasi përmendet tregimi i Ademit alejhi selam me shejtanin, Allahu i Lartësuar na thërret me katër thirrje, por a do të këshillohemi?!
- Jepen bisedat e ndryshme mes banorëve të xhenetit, banorëve të zjarrit dhe atyre të A'rafit.

Mundohu ta paramendosh veten në njërin nga këto grupe.

- Ky xhuz përfundon me pesë tregime të Pejgamberëve, andaj le të meditojmë mirë për shkaqet e shkatërrimit të përgënjeshtuesve të Pejgamberëve, që të largohemi prej tyre.

Xhuzi i nëntë

- Tregimi i Musait alejhi selam është nga tregimet më të gjata në Kur'an dhe një nga shkaqet e kësaj zgjatjeje është lidhshmëria e tyre me çifutët dhe intrigat e tyre. Fatkeqësisht në këtë ummet gjenden njerëz të thjeshtë dhe dijetarë që u përngajnë çifutëve.
- Mundimet e Musait alejhi selam nga faraoni ishin të mëdha dhe sa më shumë shtoheshin mundimet, po aq shtoheshin edhe kthimi i Musait tek Zoti i tij, i Cili nuk e la asnjëherë vetëm.

- Kur sprova u vështirësua edhe më shumë, Musai alejhi selam e udhëzoi popullin e tij që të kërkojnë ndihmë nga Allahu dhe të bëjnë sabër, u tha atyre se toka i takon Allahut dhe se përfundimi do t'u takojë njerëzve të devotshëm. Medito për këtë!
- Mëshira e Allahut ka përfshirë çdo gjë. Allahu përmendi se këtë mëshirë do ia caktojë një llojit nga robërit e Tij, ndaj medito për cilësitë e tyre se ndoshta bëhesh edhe ti prej tyre.
- Rrëfëhet për fshatin që ishte pranë detit, pastaj jepet përfundimi i atyre që urdhëronin për të mirë dhe ndalonin nga e keqja si dhe përfundimi i atyre që tejkaluan kufijtë.
- Merr mësim nga tregimi i atij që Allahu i dha mësimet e Tij, por ai u largua prej tyre dhe shiko se si Allahu e përngjau me krijesat më të fëlliqura, edhe pse më herët ishte në vendin më të ngritur.

- Flitet për fillimin e krijimit, pastaj kundërshtohet mundësia e dobisë nga idhujt që adhurohen në vend të Allahut.
- Kur sahabët pyetën për prenë e luftës, u orientuan në gjëra më të rëndësishme, sikurse devotshmëria, pajtimi mes njerëzve dhe përgjigja për pyetjen e tyre u vonua deri pas ajetit të 40-të.
- Përmendet me hollësi Lufta e Bedrit, mënyra e daljes në këtë luftë dhe sqarohen disa ngjarjeve që ndodhën në të.

Xhuzi i dhjetë

- Vazhdon rrëfimi për përshkrimin e vendit të Luftës së Bedrit dhe pastaj për ëndrrën e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.
- Thirrja përmban gjashtë këshilla për arritjen e fitores dhe vazhdimin e saj dhe pastaj sqarimin e kurtheve të shejtanit dhe ushtarëve të tij nga radhët e hipokritëve.

- Surja El Enfal përmbillet duke sqaruar lidhjen e botës islame, e cila është vëllazërimi i përbashkët për të ndihmuar shpalljen e vetme të Zotit.
- Surja Tevbe fillon duke caktuar afatin e marrëveshjes mes të Dërguarit të Allahut dhe politeistëve e çka pason pastaj në gjendje lufte apo paqeje.
- Rrëfimi për rregullat e përmbajtjes së premtimëve dhe thyerjes së tyre si dhe rrëfimi për ndalimin e politeistëve që të hyjnë në Xhaminë e Shenjtë në Mekë si dhe ndalesa për shfaqjen e dashurisë ndaj tyre.
- Luftimi i pasuesve të librit derisa t'i japin tatimin shtetit islam dhe duke qenë të nënçmuar e pastaj përmendja e disa bindjeve të kota të tyre.
- Numërimi i muajve (kalendari) duhet të jetë sipas kalendarit islam të hixhretit, pastaj sqarimi mbi muajt e shenjtë dhe caktimi i vitit të ligjsh-

ëm dhe prishja e zakonit të jobesimtarëve, të cilët bëjnë dredhi në muajt e shenjtë.

- Nxitja e muslimanëve që të shpeshtojnë pranimin e thirrjes së Allahut për të ikur për luftë në rrugën e Tij.
- Kritikimi i hipokritëve të cilët ngecin, arsyetohen, kërkojnë leje që të mos shkojnë në luftë, edhe pse nuk kanë kurrfarë arsye për këtë.
- Përmendja e cilësive të hipokritëve dhe kërcënimi i Allahut ndaj tyre me dënim si dhe përmendja e cilësive të besimtarëve dhe çfarë u ka përgatitur Allahu atyre në botën tjetër.
- Ndalimi i Allahut ndaj Pejgamberit sal-Allahu alejhi ve sel-lem që të kërkojë ndihmë nga hipokritët në luftë dhe gjithashtu ndalimi ndaj tij që të kërkojë falje për ta apo t'ua falë namazin e xhenazes atyre.

Xhuzi i njëmbëdhjetë

- Vazhdimi i rrëfimit për hipokritët, pastaj përmendja e beduinëve, të mirët dhe të këqijtë, pastaj përmendja e muhaxhirëve dhe ensarëve.
- Përmendja e xhamisë famëkeqe dhe qëllimi i keq për ndërtimin e saj dhe për këtë arsye Allahu i Lartësuar e ndaloi Profetin e Tij të falej në atë xhami. Pastaj përmendet xhamia e cila meriton kujdes dhe falje në të.
- Cilësitë e atyre që shitën veten për hir të Allahut, pastaj përmendja e ndalesës për Pejgamberin dhe ata që kanë besuar që të kërkojnë falje për politeistët.
- Kur zemra të digjet me zjarrin e mëkatit, pasuesi i Kur'anit duhet të kujtojë tregimin e tre sahabëve të cilët nuk shkuan në Luftën e Tebukut. A thua këto ajete duhen kaluar pa medituat?!

- Fundi i sures Et-Tevbe flet për lidhjen e njerëzve me Kur'anin, duke bërë një ndarje e cila duhet të meditohet mirë në mënyrë që mos të jesh nga lloji i të humburve.
- Sqarimi i argumenteve të Allahut në univers në suren Junus, pastaj përmendja e shembujve për të argumentuar ekzistimin e Allahut.
- Ngritja e argumentit ndaj politeistëve dhe sfidimi i tyre me Kur'an.
- Çfarë ke marrë nga cilësitë e Kur'anit që ka përmendur Allahu në ajetin 58 dhe 58 të sures Junus?
- Kush janë evliatë e vërtetë të Allahut? Medito për ajetet 62, 63 dhe 64 e ndoshta do të jesh nga ata.
- Përmendja e tregimit të Nuhut, pastaj tregimit të Musait me faraonin dhe nxjerrja në pah e ngj-

arjes së mbytjes së faraonit, që të jetë dëshmi dhe argument për ata që vijnë pas tij.

- Qartësimi i urdhrit të Allahut ndaj të Dërguarit të Tij që të jetë i vendosur në besim, në pasimin e shpalljes si dhe të ketë durim derisa të gjykojë Allahu.

Xhuzi i dymbëdhjetë

- Fillimi i sures Hud flet për politeistët që përgënjeshtruan të vërtetën dhe për sfidën e Kur'anit ndaj tyre.
- Përmendet tregimi i Nuhut dhe sqarimi i debatit që ndodhi mes tij dhe popullit të tij, pastaj urdhri i Allahut që Nuhu alejhi selam të ndërtojë anijen si dhe qartësohet ndodhia e përmbytjes.
- Në debatin e Nuhut me djalin e tij qartësohet se dashuria ndaj Allahut nga besimtarët e sinqertë është më e madhe se çdo dashuri, edhe nëse është pjesë e trupit të tij, fëmijë i tij.

- Në tregimin e Hudit mësojmë se istigfari është shkak për arritjen e forcës abstrakte dhe konkrete.
- Populli i Hudit e përgënjeshtroi Hudin alejhi selam, madje i tha se ishte i sëmurë nga xhinnët, por ai bëri durim dhe u mbështet tek Allahu, kështu që Allahu e shpëtoi prej tyre. Merr mësim nga ky rast.
- Përmendja e shumë tregimeve të tjera të Pejgamberëve dhe çfarë pësuan ata në rrugën e thirrjes për tek Allahu.
- Në tregimin e Shuajbit alejhi selam del në shesh kujdesi i Islamit për anën ekonomike dhe mbikëqyrja e Allahut në këtë.
- Sqarimi i shkurtër i tregimit të Musait alejhi selam me faraonin, pastaj bërja shenjë për disa ngjarje të Ditës së Kiametit dhe rrëfimi për të lumturit dhe të mjerët në atë ditë.

- Kjo sure përmbillet me urdhër për qëndrueshmëri në rrugën e Allahut dhe durim në të.
- Fillimi i sures Jusuf flet për zilinë e vëllezërve dhe sprovën e gruas së bukur, mirëpo pasi ai nuk u lëkund, atëherë në fund kori dobinë.
- Sqarimi i detajuar në lidhje me atë se çfarë ndodhi mes Jusufit dhe vëllezërve të tij, hedhja e tij në pus si dhe përfundimi i tij tek mbreti i Egjiptit.
- Tregimi i joshjes që i bëri gruaja e mbretit Jusufit, pastaj dalja në shesh e mbrojtjes së Jusufit nga ky mëkat falë sinqeritetit ndaj Allahut. Sa ekziston tek ti sinqeriteti, që pastaj përmes tij të ballafaqohesh me këto epshe?!
- Tregimi i Jusufit alejhi selam na tregon se thirrja për tek Allahu kur ngulitet në shpirt, e bën njeriun të mos ndalet edhe nëse është i burgosur.

Xhuzi i trembëdhjetë

- Vazhdimi i tregimit të Jusufit alejhi selam dhe ardhja e vëllezërve të tij tek ai, kërkesa e tij drejtuar atyre që të sjellin edhe vëllanë e tyre nga babai.
- Porosia e Jakubit alejhi selam ndaj fëmijëve të tij, pastaj hyrja e tyre tek Jusufi dhe rrëfimi i humbjes së gotës së mbretit.
- A more mësim nga durimi i Jakubit alejhi selam? Cili ishte përfundimi i durimit të tij?!
- Jusufi alejhi selam i përkufizoi gjërat që e ngritën atë në pozitë të lartë dhe ato gjëra janë: devotshmëria ndaj Allahut dhe durimi. Realizoji këto të dyja që të arrish fitore të madhe.
- Edhe pas shumë sprovave që i ranë mbi kokë Jakubit alejhi selam, megjithatë nuk e ndryshoi kurrë mendimin e mirë ndaj Allahut.
- Pas gjithë atij durimi që bëri Jusufi dhe faljes së vëllezërve të tij... pas gjithë kësaj ai i lutet Allahut që ta vdesë atë si musliman!

- Kjo sure përmbillet duke përmendur argumentet e Allahut në univers, pastaj duke përmendur dërgimin e Pejgamberëve dhe pastaj theksohet marrja e mësimet nga tregimet e Kur'anit.
- Surja Err-Rra'd fillon duke treguar për universin dhe aludon për madhërinë e Allahut, pastaj sjell shembuj për Kur'anin dhe madhërinë e tij.
- Përmenden dhjetë porosi, të cilave kush u përmbahet, do të ketë shpërblim: “Këtyre u takon shpërblimi në shtëpinë e fundit: xhenneti i Adnit, në të cilin do të hyjnë ata...”
- Surja Ibrahim fillon me tregimin e Musait alejhi selam dhe Profetëve të tjerë që u dërguan tek popujt e tyre dhe tregon se si ata iu mbështetën Allahut dhe bënë durim për mundimet e tyre.
- Përmendet një ngjarje nga ngjarjet e Ditës së Kiametit, se si shejtani distancohet nga pasuesit e tij në atë ditë. Ruaju se mos të mashtron shejtani!

- Përmendet shembulli për fjalën e mirë dhe fjalën e keqe, pastaj numërimi i disa të mirave të Allahut ndaj njeriut, mirëpo a e ke falënderuar Atë?!
- Ardhja e Ibrahimit në Mekë përmban tregime të mahnitshme për mbështetjen tek Allahu dhe madhërimi që i bënte Allahut.
- Në fund të sures Ibrahim përmendet përfundimi i të padrejtëve dhe gjendja e kriminelëve në atë ditë kur do të shndërrohet toka dhe qielli me një tokë dhe qiell tjetër.

Xhuzi i katërbëdhjetë

- Surja El Hixhër fillon duke sqaruar ruajtjen që Allahu i bëri librit të Tij, Kur'anit, dhe e ngushëllon Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem duke i treguar torturat që kanë pësuar Pejgamberët para tij.
- Tërhiqet vëmendja tek madhësia e krijimit të Allahut në univers, pastaj përmendet ringjallja dhe argumentet për mundësinë e ndodhjes së saj.

- Sqarohet me hollësi fillimi i krijimit të njerëzve e xhinëve dhe urdhri për Iblisin që t'i bëjë sexhde Ademit dhe kundërshtimi i tij.
- Sqarohet tregimi i Ibrahimit, Lutit si dhe bano-rëve të Hixhrit.
- Fundi i sures El Hixhër përmban ilaç për atë që gjen vështirësi në gjoksin e tij që t'i përmbahet tesbihut (thënia subhanAllah) dhe adhurimit.
- Surja En-Nahël ndryshe quhet edhe surja e mirësive, ndaj medito për të dhe falëndero Atë që i dha këto mirësi.
- Në suren En-Nahël ka argumente të ndryshme për veçimin e Allahut me adhurim dhe po ashtu tregohet kotësia e ortakërisë ndaj Allahut.
- Pastaj përmenden përgënjeshtresit e Kur'anit dhe ata që i kanë besuar atij, përmendet edhe përfundimi i të dyja palëve.

- Pasi Allahu përmend të mirat e Tij ndaj robërve, më pas përmend fshatin që i ka mohuar këto të mira të Zotit dhe se si e ka dënuar atë fshat, andaj ki kujdes të mos jesh nga ata që mohojnë të mirat e Zotit dhe pastaj të të godasë dënimi i Tij.
- Në fund të kësaj sureje ka nxitje për thirrje në rrugën e Zotit me urtësi dhe këshillë të mirë si dhe për durim nga vështirësitë dhe torturat.

Xhuzi i pesëmbëdhjetë

- Fillimi i sures El Isra flet për fakte të rëndësishme mbi Xhaminë el Aksa, pastaj përmend hyrjen e bijve të Israilit në të dhe çrregullimin që bëjnë ata.
- Biseda rreth udhëzimit të Kur'anit dhe vënia në pah e të dy botëve dhe vrapuesit pas tyre.
- Përmendja e njëzet porosive të mrekullueshme, të cilat kanë lidhje me çështjet më të rëndësishme.

me edukative dhe sociale, andaj medito për qëndrimin tënd ndaj tyre.

- Kundërshtimi i politeistëve me argumente dhe shkatërrimi i thirrjes së tyre për ortakëri ndaj Allahut, pastaj përmendja e bisedës me Iblisin në rastin e krijimit të Ademit alejhi selam.
- Udhëzime të shenjta për Pejgamberin tonë sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, që ai të mos mbështetet tek politeistët qoftë edhe shumë pak, përkundrazi, ai duhet të kthehet tek Zoti i tij duke përgënjeshtuar kërkesat e politeistëve dhe argumentet e tyre dhe duke përmendur argumentet e Allahut në gjithësi.
- Në fundin e kësaj sureje ka ngushëllim për Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, duke përmendur përgënjeshttrimin e faraonit ndaj Musait, pastaj duke theksuar fort se Kur'ani ka zbritur nga Allahu i Lartësuar.

- Surja El Kehf flet për katër sprova, të cilat janë feja, pasuria, dituria dhe fuqia.
 - Feja është tregimi i banorëve të shpellës, një tregim i gjallë për çdo fillestar që dëshiron të pasojë rrugën e vërtetë.
 - Pasuria përmendet në tregimin e dy njerëzve, i pasuri që përgënjeshtroi Ditën e Kiametit dhe i varfri i cili ishte besimtar në Allahun, pastaj rrëfëhet përfundimi i secilit prej tyre.
 - Dituria jepet me tregimin e Musait me Hidrin, që është shembull i mrekullueshëm për nxënësit e dijes në edukatë, ambicie të lartë, urdhër për të mirë dhe ndalim nga e keqja.
 - Fuqia përmendet me tregimin e Dhul Karnejnit, i cili është shembull për njerëzit që aplikojnë gjykimin, që të përdorin pozitën e tyre për të ngritur drejtësinë mes njerëzve.

- Është përmbyllur surja El Kehf duke treguar ngjarje nga dita kur do të dalim para Allahut, pastaj përmendet përfundimi i jobesimtarëve dhe i besimtarëve.
- Është përmendur fjala errahmeh-mëshirë dhe degëzimet e saj në suren Merjem gjashtëmbëdhjetë herë, ndaj kërkoji vendet e kësaj mëshire në këtë sure, pastaj shiko shkaqet e tyre, ndoshta kështu do ta arrish mëshirën në muajin e mëshirës.
- Surja Merjem fillon me tregimin e Zekerijas dhe flet mbi fuqinë e Allahut për t'i dhënë fëmijë ndonëse atij i ishin thinjur flokët dhe gruaja e tij kishte kaluar kohën e lindjes, andaj pas kësaj ngjarjeje a mund të bëhet kush pesimist?
- Tregimi i hollësishëm i lindjes së Isait nga Merjemi si dhe tregimi për të folurit e tij sa ishte në djep duke thënë se është rob dhe i Dërguar i Allahut.

- Tregimi i Ibrahimit alejhi selam dhe polemikat e tij me babanë në lidhje me adhurimin e idhujve, duke përdorur shprehjen e butë në thirrjen e tij (duke i thënë: o babai im), edhe pse ai ishte politeist.
- Përmendja e disa Pejgamberëve dhe nxjerrja në pah e disa ngjarjeve në ditën e mahsherrit, pastaj përgënjeshtrimi i dyshimeve të atyre që pretenojnë se Allahu ka fëmijë.
- Surja Ta Ha fillon duke rrëfyer për Musain alejhi selam dhe ndihmën që Zoti i dha atij, pastaj dërgimi i tij për te faraoni si dhe sfida me magjistarët.
- Magjistarët e faraonit në fillim të ditës ishin jobesimtarë, kurse në fundin e saj u bënë besimtarë të begatë, andaj medito për shpejtësinë e ndikimit të imanit tek ata.

- Nderimi që Allahu ua bëri bijve të Israilit duke i nxjerrë nga qyteti Kibt dhe duke e fundosur far-aonin dhe popullin e tij në det.
- Tregimi i Samiriut, i cili prodhoi viçin të cilin e adhuruan bijtë e Israilit në mungesë të Musait alejhi selam.
- Gjendja e atyre që ia kanë kthyer shpinën Kur'anit në Ditën e Kiametit dhe rrëfimi i një pamjeje nga pamjet e frikshme dhe trishtuese të asaj dite.
- Përkujtimi i njerëzve për armiqësinë e shejtanit ndaj njeriut, nga ngjarja që përmban tregimi i Ademit dhe cytjet e shejtanit ndaj tij. Andaj ruaju nga armiku i babait tënd!
- Kjo sure përfundon duke ngushëlluar Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem për fjalët që thonë politeistët si dhe për ta përforcuar atë në fe.

Xhuzi i shtatëmbëdhjetë

- Surja el Enbija fillon duke paralajmëruar për ringjalljen dhe vërtetësinë e ndodhjes së saj dhe se ajo është afruar. Por a thua a je përgatitur për të?!
- Aprovimi i tevhidit përmes debateve logjike dhe argumenteve konkrete të dukshme, gjithashtu duke përmendur Ditën e Kiametit.
- Tregimi i Ibrahimit në rastin e thyerjes së idhujve është shembull i shkëlqyer i mendjemprehtësisë me mbështetjen e fuqishme tek Allahu i Lartësuar.
- Rrëfimi i tregimeve të shumta të Pejgamberëve dhe se si Allahu ka shkatërruar kundërshtarët e tyre dhe si i ka ngritur njerëzit e dashur të Tij.
- Përmenden shembuj të shkëlqyer të lidhjes së fortë të Pejgamberëve me Zotin e tyre si dhe shpëtimi i tyre në kohët e rënda nga ana e Zotit.

- Surja El Enbija përfundon duke përmendur përfundimin e politeistëve dhe zotave të tyre, pastaj thërret për njëshmërinë e Allahut.
- Surja El Haxh fillon duke frikësuar njerëzit nga trishtimet e dridhjes së kiametit si dhe tërheq vërejtjen nga pasimi i shejtanit.
- Polemizohen politeistët në mohimin e ringjalljes, duke sjellë argumentet me fillimin e krijimit të njeriut si dhe ngjalljen e tokës së vdekur.
- Sqarohet se si Allahu ka obliguar haxhin për Ibrahimin alejhi selam, pastaj përmenden disa shtylla dhe gjëra të pëlqyera të haxhit.
- Madhërimi i Allahut duke madhëruar shenjat e Tij të haxhit dhe kurbanit, saqë këto shenja kalojnë nga tradita dhe konsiderohen adhurime.
- Përmendja e largimit të muhaxhirëve nga shtëpitë e tyre si dhe përmendja e obligimeve të atyre që Allahu ua ka mundësuar të sundojnë tokën.

- Përmendja e disa popujve të cilët kanë kundërshtuar të Dërguarit e tyre, pastaj përmendja e disa kurtheve të shejtanit dhe sprovave të tij.
- Përmendja e argumenteve që tregojnë fuqinë e Allahut të Lartësuar, po ashtu përmendja e ringjalljes dhe polemizimi i politeistëve.
- Kjo sure përfundon duke thirrur për xhihad, për praktikimin e obligimeve dhe lidhje të fortë me Allahun.

Xhuzi i tetëmbëdhjetë

- Derisa je duke lexuar cilësitë e përmendura në fillim të sures El Mu'minun, a nuk e ke pyetur veten ndonjëherë se çfarë kam realizuar nga këto cilësi?
- Tregimi i Nuhut alejhi selam dhe të mësuarit e tij nga Allahu që të falënderojë Allahun pasi e ka shpëtuar nga populli zullumqar.

- Vështrim i shpejtë i disa tregimeve të Pejgamberëve për të ngushëlluar zemrën e Muhamedit sal-Allahu alejhi ve sel-lem.
- Shfaqja e ngjarjes së agonisë, vdekjes, fryrjes së burisë, pastaj përfundimi i përgënjeshtresve të argumenteve të Allahut dhe dënimi prej Allahut me zjarr.
- Fillimi i sures El Mu'minun është “vërtet kanë fituar besimtarët”, kurse fundi i saj “Allahu nuk shpëton jobesimtarët”. Sa dallim i madh!
- Surja Nur fillon duke treguar për masën e dënimit për amoralitet, shpifjen në nder si dhe tregon dispozitën e mallkimit (mes bashkëshortëve).
- Tregimi i shpifjes për Aishen radijAllahu anha na mëson të sigurohemi për lajmet dhe të ruajmë gjuhën dhe pastaj tregon rrezikun e madh të gjuhës.

- Në rastin e kësaj shpifjeje tregohet vlera e nënës sonë, Aishes radijAllahu anha, andaj ki kujdes, ruaju nga ata që përgënjeshtrojnë Kur'anin.
- Kritika nga dashuria për të shfaqur mëkatet mes besimtarëve dhe besimtareve si dhe urdhri për të falur në rast lëndimi prej të tjerëve.
- Urdhri për të kërkuar leje kur hyjmë në shtëpi të huaja, po ashtu urdhri për të ulur shikimin dhe për të ruajtur organet gjenitale.
- Udhëzimi për t'u martuar dhe vënia në pah që Allahu kujdeset për pasurinë si dhe vetëpërmblajtja në rast varfërie. Po ashtu flitet për ndalimin e kurvërisë.
- Sjellja si shembull e dritës së Allahut dhe veprave të jobesimtarëve, pastaj përmendja e disa argumenteve të Allahut në univers.
- Përmendja e hipokritëve dhe nxjerrja në pah e cilësisë së ikjes dhe zmbropsjes nga gjykimi i Allahut. Kështu që kontrolloje edhe veten në këtë!

- Allahu u ka premtuar atyre të cilët kanë besuar se do t'i bëjë udhëheqës në tokë, por me disa kushte të cilat duhet t'i shikosh në suren En-Nur.
- Përmendja e dispozitës së kërkimit të lejes për fëmijët të cilët hyjnë në dhomat e prindërve, pastaj përmendja e dispozitës së mbulesës për gratë e moshuara, të gjitha këto llogariten nga muret e nderit të cilat i sqaron surja En-Nur. Pastaj flet për dispozitën e ngrënies në shtëpitë e të afërmeve.
- Në fund të kësaj sureje qëndron një thirrje për mënyrën e edukatës që duhet kemi me Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.
- Surja El Furkan fillon duke lavdëruar Atë që ka zbritur Kur'anin, mirëpo sa hise ke tek bereqeti i këtij Kur'ani?!
- Më pas përmendet përgënjeshtrimi i dyshimeve të politeistëve rreth Kur'anit dhe rreth të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

- Përshkruhet Dita e Kiametit dhe tërhiqet vëmendja për rrezikun e shoqëruesve të këqij. Pra, ki kujdes për këtë para se t'i kafshosh duart!
- Përmenden disa shembuj se si Allahu i ka shkatërruar popujt që përgënjeshtroan Pejgamberët, me qëllim që përmes këtyre shembujve të tregohet tërthorazi gjendja e jobesimtarëve kurejshë.
- Argumentohet për njësimin e Allahut përmes shenjave të Tij në gjithësi. Lexoju pra këto në librin e gjithësisë (Kur'anin, i cili na mëson shumë gjëra nga gjithësia).
- Nëse lexon cilësitë e robërve të devotshëm të Allahut në fund të sures El Furkan, cilët mendon se i plotësojnë ato cilësi?
- Surja Esh-Shuara fillon me ngushëllimin për Pejgamberin sal-Allahun alejhi ve sel-lem ndaj torturave që përjeton nga mosdëgjimi i popullit të tij.
- Surja sjell disa tregime, të cilat janë që të gjitha përforcim për Pejgamberin sal-Allahun alejhi ve sel-lem.

- Në tregimin e Musait alejhi selam shfaqet mbështetja e fortë tek Allahu në kohët më të vështira: “Assesi (nuk na zë ushtria e Faraonit), me Mua është Allahu, do më udhëzojë.” Sa bindje e thellë!
- Vetëm zemra e pastër do t’i bëjë dobi njeriut në Ditën e Kiametit, por a thua a kemi hulumtuar ndonjëherë nëse zemrat tona janë të pastra apo jo?
- Kur Nuhu alejhi selam e ftoi popullin e tij dhe i urdhëroi për të mirë dhe i ndaloi nga e keqja, ata e kërcënuan se do ta masakrojnë. Kurse ne na dëmtojnë fjalët e njerëzve, të cilat janë kalimtare. Eh sa dallim të madh ka mes nesh dhe Nuhut alejhi selam!
- Hudi alejhi selam i kujtoi popullit të tij të mirat që Allahu u dha atyre dhe po ashtu u kujtoi se falënderimi për këto të mira bëhet duke qenë i devotshëm.

- Në tregimin e Pejgamberit të Allahut, Salihut alejhi selam, tërhiqet vërejtja që të mos respektohen tepruesit dhe keqbërësit, andaj kujdesu që të të mos devijojnë nga e vërteta.
- Qartësohet rreziku i pranimit të së keqes edhe nëse nuk e vepron. Shiko përfundimin e gruas së Lutit alejhi selam!
- “Adhuroje Allahun sikur e sheh Atë, edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty”, shfaqet qartazi në tregimin e Shuajbit alejhi selam, po ashtu edhe në përfundimin e sures Esh-Shuara: “Ai i Cili (Allahu) të sheh atëherë kur ngrihesh (për adhurim)”.
- Kjo sure përfundon duke treguar për pozitën e Kur’anit dhe urdhëron për thirrje për tek Allahu.
- Në fillim të sures En-Nemël përmendet se Kur’ani është udhëzues dhe përgëzim për atë tek i cili përmbushen disa cilësi, kështu që kërkoji ato.
- Në tregimin e Musait alejhi selam me Faraonin sqarohen pasojat e mendjemadhësisë dhe pad-

rejtësisë, për shkak të të cilave ishin mohuar argumentet e Allahut.

- Medito për besnikërinë e pupëzës dhe kujdesin e saj për njëshmërinë e Allahut si dhe mosmashtrimin e saj nga ajo që posedojnë jobesimtarët nga të mirat e dunjasë. Njëshmëria e Allahut duhet të jetë përherë para gjithçkaje.
- Tregimi i Sulejmanit alejhi selam dhe vendi Sebe' tregojnë se si përdoret pushteti në respektim ndaj Allahut apo në mëkat ndaj Tij.
- Në tregimin e popullit të Profetit Salih sqarohet se sado që tradhtarët të bëjnë kurthe, Allahu do t'i mposhtë me kurthet e Tij, madje ata nuk i kuptojnë fare ato.

Xhuzi i njëzetë

- Tregimi i Lutit alejhi selam tregon se deri ku ka mundësi të shkojë gjendja e keqbërësve, saqë ata

nuk pranuan të qëndrojnë në mesin e tyre nje-rëzit e pastër nga mëkatet.

- Në suren En-Nemël gjenden pesë pyetje, të cilat ngulitin bazat e tevhidit dhe sqarojnë të vërtetën për çdo njeri të mençur.
- Kundërshtohen dyshimet e politeistëve dhe në fund përmenden disa pamje nga Dita e Kiametit.
- Surja El Kasas fillon duke i qetësuar besimtarët e dobët për të ardhmen dhe se Allahu do t'i bëjë ata mëkëmbës në tokë.
- Sqarohet me hollësi tregimi i lindjes së Musait alejhi selam, pastaj gjidhënia dhe edukimi i tij në pallatin e Faraonit. Po ashtu jepet tregimi kur Musai vrau egjiptianin pa qëllim.
- Çfarë të bën të kuptosh rasti kur ajo grua shkoi tek Musai alejhi selam duke u turpëruar?!
- Përshkruhet udhëtimi i Musait alejhi selam me familjen e tij për tek qyteti i tij si dhe forcimi i tij

duke pasur ndihmën e vëllait të tij; të gjitha këto aludojnë se thirrësi nuk është i pavarur nga ndihmëtarët që i dalin në ndihmë, mirëpo mund të ndodhë që nuk mund të gjejë ndihmëtar tjetër pos Allahut, që është Ruajtësi dhe Ndhimëtari më i mirë.

- Detyrohen politeistët që t'i besojnë Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ngase ai po u rrëfen tregimet e Bijve të Izraelit, të cilat nuk i ka përjetuar.
- Shfaqet fuqia e Allahut në rrotullimin e natës dhe të ditës. E sikur Ai të donte, do ta zgjaste njëri prej tyre përgjithmonë.
- Jepet tregimi i Karunit me pasurinë, ngase pasuria është shkatërrim nëse pronari i saj nuk e njeh të drejtën e Allahut në atë pasuri.
- Në fund të sures El Kasas bëhet shenjë se ashtu sikurse u nxor Musai alejhi selam nga vendi i tij

e pastaj u kthye, ashtu do bëhet edhe me Muhamedin.

- Surja El Ankebut nis me tregimin e llojeve të sprovave që godasin thirrësin në rrugën e tij, si: sprovat e familjes, tortura trupore dhe sprovat e dunjasë. Në fund të sures tregohet rrugëdalja nga këto sprovat, ku Allahu thotë: “Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt udhëve Tona.”
- Shembujt e njëpasnjëshëm nga dënimi i popujve të ndryshëm na bëjnë të mendojmë se edhe ne nuk jemi të sigurt nga këto dënime.

Khuzi i njëzetënjëtë

- Urdhërohet polemizimi me pasuesit e librit (të krishterët dhe çifutët) në formën më të mirë, por çfarë mendon për formën e debatit me vëllanë tënd?!

- Në fund të sures El Ankebut bëhet thirrje që të meditohet për gjithësinë dhe se mundimi e sakrifica të dërgojnë tek udhëzimi.
- Surja Er-Rrum fillon duke përmendur humbjen e romakëve, por premtohet gjithashtu se ata pastaj do të fitojnë dhe se Allahu ndihmon kë të dojë.
- Medito si Allahu i Lartësuar i kritikoi politeistët për shkak të pakujdesisë së tyre ndaj ahiretit! Por a e kuptove se si lidhja me dunjanë është sëmundje?
- Thirrje për të medituar për argumentet e Allahut në krijimin e njeriut, rrotullimin e tokës dhe të ditës, zbritjen e shiut dhe argumentet e tjera.
- Thirrje për të qëndruar në natyrshmëri (Islam), pastaj vënia në pah se shkakut i shfaqjes së çrregullimit dhe prishjes janë veprat e njerëzve, ndaj

mos u bëj ndihmëtar i shfaqjes së çrregullimit dhe prishjes.

- Kthimi mbrapa duke përmendur disa argumente të Allahut në gjithësi, pastaj përfundimi i sures duke bërë thirrje për durim.
- Surja Lukman fillon duke përshkruar të mirët dhe shpërblimin e tyre, pastaj thekson ata që janë të njohur për fjalë të kota si dhe dënimin që meritojnë.
- Porositë e Lukmanit ndaj djalit të tij filluan me tevhidin, pastaj me respektimin e prindërve dhe shoqërimin e tyre në punë të mira edhe nëse janë jobesimtarë. Vërehet se porosia e Lukmanit filloi me përmirësimin e besimit para veprave, ndaj medito për këtë dhe gjithashtu lidhe me rrëfimin e sures për argumentet e tevhidit që gjenden në gjithësi, duke treguar se si politeistët

kthehen tek Allahu në kohëra të vështira, por i bëjnë ortak Atij kur janë në liri dhe komoditet.

- Në fund të kësaj sureje bëhet thirrje për t'u përgatitur për Ditën e Kiametit, pastaj tregohet për çelësat e gajbit (së fshehtës), të cilat nuk i di askush pos Allahut.
- Surja Es-Sexhde fillon me tregimin për fillimin e krijimit dhe mbarimin e tij, pastaj përfundimin e krijesave ose në xhennet ose në zjarr.
- Surja Sexhde përmend disa cilësi të besimtarëve, por cilësitë më parësore të cilat i japin njeriut udhëheqjen në fe janë durimi dhe bindja.
- Në fund të sures Es-Sexhde bëhet thirrje për të medituar për argumentet e Allahut dhe po ashtu për largimin nga inatçinjtë dhe kokëfortët ndaj së vërtetës.

- Surja El Ahzab fillon duke e thirrur Pejgamberin për t'ia pasur frikën Allahut! Po ti, a zemërohesh nëse të thuhet kjo fjalë?
- Përmenden nënat e besimtarëve si dhe sqarohet se ndalimi i martesës me to është njësoj sikurse ndalimi i martesës me nënat biologjike.
- Jepen përshkrime mahnitëse nga lufta e Ahzabit, të cilat shfaqin gjendjen e muslimanëve dhe të hipokritëve në momentet e vështira të luftës.

Xhuzi i njëzetedytë

- Përmendja e gjendjes së Pejgamberit me gratë e tij si dhe porosia e Allahut për to, që ato të rrinë në shtëpitë e tyre. A thua gratë tona janë më të mira se ato?!
- Përmendja e vlerës së familjes së Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, pastaj e muslimanëve dhe muslimaneve në përgjithësi.

- Vënia në pah e disa rregullave që lidhen me divorcin si dhe mbulesën e nënave të besimtarëve, prandaj Allahu e mëshiroftë atë grua që i pason ato.
- Përkushtimi i dukshëm ndaj mbulesës dhe rregullave të saj, duke e lidhur çështjen e mbulesës me nënshtimin ndaj urdhrit të Allahut si dhe duke u tërhequr vërejtjen hipokritëve.
- Në fund të sures përmendet përfundimi i jobesimtarëve dhe pasuesve të tyre, pastaj përmendet besa që ka pranuar njeriu.
- Surja Sebe' fillon duke shkatërruar bazat e polit-eizmit dhe mohimit të ringjalljes.
- Tregohet udhëzimi i Pejgamberëve në raport me mirësitë dhe falënderimi për to, kurse shumica e njerëzve ndaj mirësive janë mohues.
- Në përleshjen mes mendjemëdhenjve dhe pasuesve të tyre ka shenja për rëndësinë e zgjedhjes

- së drejtë në pasim, në mënyrë që të mos pendo-
hemi.
- Kjo sure përfundon duke i thirrur politeistët të meditojnë dhe i frikëson me ditën në të cilën nuk bën dobi më besimi.
 - Surja Fatir fillon duke u kujtuar njerëzve mëshirën dhe mirësitë e Allahut dhe duke ua tërhequr atyre vërejtjen nga mashtrimet e dunjasë dhe të shejtanit si dhe duke u kujtuar madhësitinë e Allahut dhe nevojën e madhe që kanë robërit për Allahun.
 - Përmenden llojet e njerëzve që trashëguan librin, pastaj shpërblimi i besimtarëve dhe jobesimtarëve.
 - Surja përmbyllet duke i mundur politeistët me argumente si dhe përmendet se dredhitë e shëmtuara nuk godasin vetëm se dredharakët.

Xhuzi i njëzetetretë

- Surja Jasin në hyrje të saj flet për Kur'anin dhe thirrjen që Profeti u bën politeistëve.
- Pastaj sjell shembullin e banorëve të fshatit, të cilët përgënjeshtroan Pejgamberët, si dhe shpëtimin e besimtarit që ishte i mëshirshëm ndaj popullit tij, pastaj tregohet për shpërblimin e këtij besimtari me xhennet.
- Më pas tërheq vëmendjen tek argumentet e Allahut në gjithësi, duke i thirrur politeistët në besim dhe duke i paralajmëruar nga adhurimi i shejtanit.
- Kjo sure përfundon duke përforcuar bindjen në fuqinë e Allahut për krijim dhe ringjallje.
- Fillimi i sures Es-Safat flet për njëshmërinë e Allahut përmes argumenteve të krijimit të krijesave të mëdha, të cilat nuk mundet t'i krijojë dikush tjetër pos Tij.

- Rrëfëhet për ringjalljen dhe llogaridhënien, pas-taj përmenden mirësitë e besimtarëve në botën tjetër dhe dënimi i përgënjeshtresve.
- Tregohet me shembull debati mes banorëve të xhennetit dhe banorëve të zjarrit, çka flet për rrezikun e shoqërisë së keqe.
- Zoti u përgjigjet më së miri lutjeve të robërve të Tij. A i je drejtuar Atij me lutje dhe përkushtim? Medito për këtë ajet: “Kur Nuhu Na thirri (në ndihmë), Ne iu përgjigjëm bukur...”
- Dorëzimi i Ibrahimit dhe Ismailit alejhima selam ndaj urdhrit të Allahut është shembulli më mahnitës në ndikimin e edukatës së mirë si dhe qartësim se ky edukim jep përfundim të mirë.
- Surja përfundon duke nënvlerësuar disa dyshime të politeistëve si dhe duke sqaruar se ushtria e Allahut është e ndihmuar.

- Surja Sad në fillimin e saj flet për lloje të ndryshme të grindjeve në tokë dhe qiell, andaj mundo-hu të meditosh për këto.
- Në suren Sad ka gjithashtu ngushëllim për Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem si dhe thirrje për të që të pasojë Pejgamberët para tij dhe të mësojë se si ata ishin të durueshëm gjatë sprovave.
- Medito se si Allahu nënshtroi për Sulejmanin disa gjëra të cilat nuk mund t'i bënte askush, por kjo gjë nuk e bëri atë mendjemadh.
- Medito për edukatën e Pejgamberëve gjatë lutjeve drejtuar Zotit: “Kujtoje robin Tonë, Ejubin, kur iu lut Zotit të vet: “Me të vërtetë, më ka goditur djalli me mundim dhe vuajtje!”
- Përshkrimi i qindra njerëzve të devotshëm dhe qindra të tjerëve të lajthitur, pastaj përshkrimi i tregimit të Iblisit dhe mospranimi që të bëjë se-

xhde ndaj Ademit për shkak të mendjemadhësisë dhe tiranisë së tij.

Xhuzi i njëzetekatërtë

- Fillimi i këtij xhuzi plotëson rrëfimin e mëherëshëm për njëshmërinë e pastër të Allahut dhe kërcënimin ndaj politeistëve.
- Nuk ka pesimizëm ndaj mëshirës së Allahut, ngase Allahu i fal të gjitha mëkatet, sado të neveritshme qofshin.
- Ku do të jesh ti atëherë kur jobesimtarët do të ngrihen për xhehennem grupe-grupe dhe besimtarët do të dërgohen për në xhennet grupe-grupe?
- Surja Gafir fillon duke përmendur faljen e Allahut dhe se Ai e pranon pendimin, po ashtu përmend dënimin e dhembshëm për kryeneçët.
- Në këtë sure përmendet gjithashtu debati në të drejtë dhe ai në të kotë.

- Në suren Gafir përmendet përgëzimi për të pënduarit dhe se do t'u mjaftonte atyre si nder që melaiket kërkojnë falje për ta.
- Rrëfëhet për Ditën e Kiametit, e cila prangos mendjen nga frikësimi i asaj dite dhe pohon se në atë ditë shfaqet madhështia e pushtetit të Allahut.
- Në tregimin e besimtarit nga paria e Faraonit ka një shëmbëlltysë për thirrësin që këshillon popullin e tij, se ai duhet të debatojë me ta me argumente dhe fakte ngase vetëm euforia nuk mjafton.
- Përmenden me hollësi shumë mirësi nga mirësitë e Allahut dhe sqarohet përfundimi i atyre që polemizojnë ndaj shenjave dhe argumenteve të Allahut.
- Surja Fussilet flet për Kur'anin Fisnik dhe gjendjen e kryeneçëve ndaj tij si dhe kritikon ata për

shkak se nuk i janë përgjigjur urdhrin të Allahut me gjithë dobësinë e tyre, kurse qiejt dhe toka, me madhësinë e tyre, u janë përgjigjur urdhrin të Allahut.

- Sqarohet rreziku i shoqërisë së keqe dhe se ata ua zbukurojnë mosbesimin dhe humbjen atyre që i shoqërojnë.
- Surja Fussilet flet edhe për çështje edukative në thirrjen për tek Allahu si dhe për edukatën e mirë.
- Kritikohen mohuesit e argumenteve të Allahut, pastaj mbrohet Kur'ani dhe sqarohet se ai vërtet është udhëzim dhe shërim.
- Në fund të sures bëhet thirrje për të medituar për universin dhe trupin e njeriut, ngase kjo metodë mund t'ua sqarojë të vërtetën atyre që e kërkojnë.

Xhuzi i njëzetepeshtë

- Surja Esh-Shura fillon me përmendjen e Kur'anit dhe se ai është paralajmërues për nënën e fshatrave (Mekën) dhe popujt rreth saj, po ashtu është paralajmërues për Ditën e Bashkimit (Kiametit).
- Allahu i Lartësuar zgjedh kë të dojë për t'ia dërguar shpalljen, ndaj nuk është çudi që të urdhërojë Muhamedin alejhi selam me një fe e cila është e ngjashme me atë që i ka urdhëruar edhe Profetët para tij.
- Përmenden disa shenja të cilat tregojnë njëshmërinë e Allahut dhe fuqinë e Tij dhe nga këto shenja është mirësia e llojllojshmërisë në dhurimin e fëmijëve kujt të dojë dhe privimin e të tjerëve nga kjo dhunti.
- Surja Esh-Shura përfundon me sqarimin se Kur'ani është shpirt me të cilin ngjallen zemrat, an-

daj a je treguar i vëmendshëm nëse ta ka ngjallur Allahu zemrën me këtë shpirt?

- Surja Ez-Zuhruf fillon me përmendjen e pozitës së Kur'anit, pastaj kalon tek polemizimi i politeistëve, pastaj te debati me ata që pasojnë baballarët e tyre pa argumente. Por a ke menduar për gjurmën negative që të lë pasimi i verbër?
- Mos u merakos për jetën! Vërtet Allahu ka ndarë mes njerëzve mjetet për të jetuar dhe disave u ka dhënë më shumë se të tjerëve: “Jemi Ne ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë, duke i ngritur në shkallë disa më lart mbi të tjerët.” (Ez-Zuhruf: 32)
- Ruaju nga shoku para se të shpresosh të largohesh nga ai, mirëpo atëherë nuk do të të bëjë më dobi pendimi.

- Në tregimin e Musait tregohet se Faraoni u argumentua me pushtetin e tij se është më i mirë se Musai alejhi selam, kështu që ruaju nga dunjaja.
- Pastaj sqarohet se të gjitha miqësitë do të jenë të pavlera në Ditën e Kiametit, përveç miqësisë mes robërve të devotshëm, andaj përmbaju njerëzve të mirë.
- Medito mirë për ngjarjen mes banorëve të zjarrit dhe ruajtësit të zjarrit, i cili quhet Malik. Kjo ngjarje përshkruhet nga fundi i sures Ez-Zuhruf.
- Fillimi i sures Ed-Duhan flet për zbritjen e Kur'anit, pastaj tall politeistët, dyshimet dhe kërcënimet e tyre, pastaj flet për gjurmët e kryelartësisë ndaj së vërtetës në këtë botë dhe ç'pasoja do të kenë personat e tillë.
- Përmend çfarë i pret njerëzit e këqij duke filluar me fjalët: "Vërtet pema e Zekkumit...." si dhe përmend çfarë i pret njerëzit e mirë me fjalët:

“Vepërmirët me të vërtetë do të jenë në vend të sigurt...”

- Fillimi i sures El Xhathije tërheq vëmendjen për shenjat e mëdha në qiell dhe tokë, pastaj tregon përfundimin e mendjemëdhenjve dhe tallësve.
- Ruaju nga pasimi i epshit, ngase disa njerëz epshin e bëjnë Zot duke mos e ndier fare!
- Kjo sure përfundon duke përshkruar trishtimin e Ditës së Kiametit dhe humbjen e madhe të keqbërësve, shpërblimin e besimtarëve dhe dënimin e jobesimtarëve.

Xhuzi i njëzetegjashtë

- Surja El Ahkaf fillon duke argumentuar përsosmërinë e krijimit të qiejve dhe tokës, se Allahu duhet të veçohet me adhurim.

- Tregohet për Kur'anin, pastaj porosia për t'u sjellë mirë me prindërit si dhe tërheqja e vërejtjes t'u thuhet atyre madje as uf.
- Në tregimin e Ahkafit sqarohet se dënimi mund të vijë ndonjëherë në formë dhuntie dhe kështu e shkatërron njeriun.
- Medito se si xhinnët kuptuan Islamin pasi dëgjuan Kur'anin vetëm në një tubim. Kush mediton për këtë?
- Surja El Ahkaf përmbillet duke thirrur për të medituar për gjithësinë, pastaj na përkujton për ditën kur do të dalim para Allahut dhe më pas bën thirrje për të pasuar Pejgamberët në durim.
- Surja Muhamed fillon duke i nxitur besimtarët t'i luftojnë jobesimtarët dhe më pas përmend përfundimin e të dy grupeve.

- Përshkruhet xhenneti dhe mirësitë e tij, pastaj xhennemi dhe dënimet e tij, pastaj përshkruhen hipokritët dhe u bëhet thirrje për të medituar për Kur'anin, në mënyrë që të pastrohen nga hipokrizia.
- Kjo sure përfundon duke dhënë porosi për muslimanët, e nëse nuk i përfillin ato, atëherë Allahu do t'i ndryshojë ata me popuj të tjerë.
- Surja El Fet'h fillon duke i përgëzuar besimtarët për përfundimin e mirë të Marrëveshjes së Hudejbijes dhe këtë marrëveshje e quajti si çlirim dhe fitore.
- I qetëson besimtarët dhe u largon mërzinë dhe po ashtu i lajmëron se e keqja do t'i godasë hipokritët dhe jobesimtarët.
- Përmendet Marrëveshja e Hudejbijes dhe ngrihet lart pozita e atyre që kanë marrë pjesë në të, pastaj tërthorazi kritikohen ata që nuk kanë ma-

rrë pjesë pa pasur pa arsye dhe thuhet se atyre nuk do t'u lejohet të marrin pjesë në çlirimin e Hajberit.

- Përmendet qartë kënaqësia e Allahut ndaj atyre që dhanë besën nën hijen e pemës, andaj ki kujdes se mos urren atë me të cilin Allahu është i kënaqur.
- Surja El Fet'h përfundon duke përmendur veçoritë e ummetit triumfues e trashëgues.
- Surja El Huxhurat është përmbledhëse e çështjeve të moralit dhe edukatës, andaj kërkoni këto gjëra në këtë sure. Shiko të gjesh ndonjë gjë nga morali i mirë dhe përmbaju asaj dhe po ashtu çdo gjë që ndalon nga morali i keq, largojtu prej tij.
- Tregohet rreziku i besimit të thashethemeve dhe se përfundimi i këtij besimi mund të të dërgojë në pishmanllëk dhe pendim, andaj në amb-

ientet mediatike vërteto sepse shumë pak prej atyre lajmeve janë të vërtetuara.

- Ngulitet rregulla e përgjithshme e vëllazërisë, e cila është e ngritur në besim.
- Përmenden disa edukata dhe sjellje me të cilat duhet të stoliset besimtari.
- Gradimi tek Allahu është i bazuar në devotshmëri, andaj ki kujdes nga fanatizmi i urryer.
- Çdo begati që e kaplon besimtarin, dhuntia dhe falënderimi për të i takon vetëm Allahut të Lartësuar.
- Surja Kaf fillon duke përmendur përgënjeshtimin që politeistët u bënë në Dërguarve, pastaj argumenton pohimin e ringjalljes.
- A ke menduar mbikëqyrjen e Allahut në fjalët që thua dhe a ke menduar për dy melekët të cilët i llogarisin mirë shprehjet e tua?!

- Pastaj përshkruhet vdekja dhe çfarë pason pas saj, sikurse ngjarja e kiametit, xhehennemi dhe xhenneti.
- Në fund të sures flitet prapë sikurse në fillimin e saj, për gjithësinë dhe pohimin e ringjalljes.

Xhuzi i njëzeteshtatë

- Fillimi i sures Edh-Dharijat përmban vërtetësinë e ndodhisë së ringjalljes dhe shpërblimit, pastaj përmendet përfundimi i jobesimtarëve dhe të devotshmëve.
- A frikësohesh për rrizkun? Allahu është betuar në Vetën e Tij se rrizku yt është në qiell dhe kjo gjë është e sigurt sikurse edhe vetë të folurit tënd.
- Përmendja e politeistëve në formë alegorike duke përmendur disa popuj përgënjeshtues dhe shkatërrimin e tyre, pastaj urdhri ndaj Pejgamb-

erit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem për t'ua përkujtuar njerëzve shpalljen.

- A ke menduar ndonjëherë sa e ke vërtetuar këtë qëllim madhor: “Nuk i kam krijuar xhinnët dhe njerëzit vetëm se të më adhurojnë.” (Edh-Dhariat: 56)
- Fillimi i sures Et-Tur përmban kërcënim për politeistët përgënjeshtres, pastaj përmend kënaqësitë dhe të mirat e të devotshmëve.
- Pesëmbëdhjetë pyetje të njëpasnjëshme e dërgojnë njeriun nga një gjendje në gjendjen tjetër dhe e detyrojnë atë të mendojë për kohën e tashme dhe për atë që do të vijë më vonë... Këto pyetje e orientuan Xhubejr ibën Mut’imin të pranojë Islamin.
- Durimi në adhurim është përmbyllja me të cilën përfundon surja Et-Tur, por a e ke edhe ti këtë gjë?

- Surja En-Nexhm fillon duke lavdëruar të Dërguarin Muhamed sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe duke pohuar pagabueshmërinë e tij, pastaj vërteton se Kur'ani është shpallje nga Allahu e zbritur përmes melekut Xhibril.
- Pastaj mohohen zotat e politeistëve si dhe fjalët e tyre për këta zota, sepse fjalët e tyre janë vetëm se hamendje pa fakte. Pastaj tërhiqet vërejtja që të mos thuhet këto fjalë të paargumentuara.
- Kjo sure përfundon duke ua përkujtuar politeistëve se çfarë i ka goditur popujt politeistë para tyre si dhe i paralajmëron ata për një dënim të afërt.
- Surja El Kamer fillon duke paralajmëruar politeistët për afrimin e Ditës së Kiametit dhe se çfarë torturash të rënda do kenë në kohën kur do të ringjallen.

- Përkujton politeistët se çfarë u ka ndodhur popujve para tyre dhe se ata nuk janë më të mirë se jobesimtarët e popujve të mëhershëm.
- Në këtë sure është përsëritur shumë fjalia se Kur'anit është i lehtësuar (për t'u mësuar përmendësh, për ta kuptuar etj.), mirëpo problemi fshihet në këtë pyetje: Kush është ai që e merr këtë këshillë?
- Surja Err-Rrahman është zbukurimi i Kur'anit, në të numërohen dhuntitë dhe e para dhunti me të cilën fillohet është dhuntia e mësimit të Kur'anit. Cila është pjesa jote në mësimin e Kur'anit? Por nuk është vetëm leximi i tij.
- Kjo sure përfundon duke përshkruar të mirat e xhennetit. A ke ti punë të mira të cilat të ndihmojnë për të hyrë në xhennet?!

- Në fillim të sures El-Vakia ka një rrëfim frikësues, por a je ndalur tek ky fillim, a ka mbetur ajo ngjarje në kujtesën tënde?
- Në Ditën e Kiametit njerëzit në bazë të punëve të tyre do të ndahen në tre lloje dhe do të shpërblehen në bazë të punëve. Zgjidh për veten tënde njërin nga këto grupe.
- Në këtë sure shfaqen disa argumente konkrete dhe tregohet se ringjallja është e vërtetë e pamohueshme dhe se refuzimi i saj është kotësi.
- Kjo sure përfundon duke përshkruar vdekjen, pastaj përsëri përmend tre llojet e njerëzve.
- Surja El Hadid fillon duke përshkruar madhërinë e Allahut, pastaj bën thirrje për besim dhe shpenzim në rrugën e Allahut.

- Përshkruhet drita e besimtarëve në Ditën e Ringjalljes, pastaj pikëllimi i hipokritëve për humbjen e kësaj drite.
- Ku jemi ne në raport me këtë ajet: “A nuk ka ardhur koha për besimtarët e vërtetë, që zemrat e tyre të përulen para këshillave të Allahut dhe para së vërtetës që Ai ka shpallur?...” (El Hadid: 16)
- Tregohet realiteti i kësaj bote, që është një e mirë kaluese, pastaj bëhet thirrje për kërkim falje dhe xhennet, pastaj bëhet thirrje për të ecur rrugës së Pejgamberëve, të cilët janë përmendur në fund të kësaj sureje.

Xhuzi i njëzetetë

- Në suren El Muxhadele tregohen rregullat e dhiharit dhe nexhvasë² si dhe hidhen poshtë int-

² *Dhihar* është kur burri e ndan gruan e tij duke i thënë se ti je sikurse nëna ime, kurse *Nexhva* ka për qëllim bisedimin mes dy personave me zë të ulët apo fshehurazi (sh.p.).

rigat e hipokritëve, pastaj sqarohet dispozita e dashurisë ndaj armiqve të Allahu edhe nëse ata janë farefis i yni. E gjithë surja flet për diturinë e madhe të Allahut, e cila përfshin çdo gjë që duket dhe çdo gjë që fshihet.

- Në suren El Hashër rrëfëhet për luftën kundër Benu Nadir dhe sqarohet dispozita e plaçkës së luftës, tregohet vlera e muhaxhirëve dhe ensarëve nga sahabët, hidhet poshtë gjendja e hipokritëve, sqarohet madhështia dhe pozita e lartë e Kur'anit, përmenden disa emra të Allahut si dhe kritikohen politeistët.
- Në suren El Mumteherine bëhet një sqarim i rëndësishëm i disa rregullave të miqësisë dhe armiqësisë, pastaj bëhet dallimi në sjellje me jobesimtarët të cilët na luftojnë dhe të tjerëve që nuk na shpallin luftë si dhe përmendet emigrimi i gr-

ave dhe besatimi që ato i dhanë Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

- Në suren Es-Saf tërhiqet vërejtja nga fjala e cila nuk praktikohet me punë, nxitet për xhihad, përmendet thirrja e Musait dhe Isait alejhimas-sel-am si dhe kujdesi për tregtinë fitimprurëse, e cila është tregtia me Allahun.
- Në suren El Xhumu'ah precizohet madhështia e Allahut, kritikohen çifutët sepse nuk punuan me dijen e tyre, nxiten besimtarët të praktikojnë obligimet, nxiten po ashtu që të lidhen sa më fort me dhikër - nga ky dhikër është edhe hutbeja e xhumasë- si dhe nxiten të mos jenë të shkujdesur nga adhurimi për shkak të dunjasë.
- Në suren El Munafikun përmenden disa cilësi të hipokritëve që të ruhemi prej tyre si dhe sqarohet humbja e madhe për atë që e huton pasuria dhe fëmijët nga përmendja e Allahut.

- Në suren Et-Tegabun sqarohet fuqia dhe dija e Allahut, përdoret frikësimi nga Dita e Ringjalljes dhe dita e humbjes dhe fitimit, tërhiqet vërejtja nga sprova e grave dhe fëmijëve, pastaj nxitet për devotshmëri dhe shpenzim në rrugë të Allahut.
- Në suren Et-Talak plotësohen rregullat e shkurorëzimit që janë cekur në suren El Bekare si dhe lidhja mes tyre dhe devotshmërisë e bamirësisë, duke përfunduar me përmendjen e popujve të cilat nuk kanë përfillur urdhrin e Allahut dhe të Dërguarit të Tij.
- Në suren Et-Tahrim kritikohet ndalimi i gjërave të lejuara duke i kënaqur të tjerët, mësohen gratë që të mos i ngushtojnë burrat e tyre me kërkesa të shumta, bëhet thirrje për edukimin e familjes dhe frikësim nga zjarri, pastaj përmenden dy shembuj për gratë e këqija si dhe dy shembuj për gratë e mira.

Xhuzi i njëzetënëntë

- Surja El Mulk zbulon disa gjurmë të sundimit të madh të Allahut, duke i bashkangjitur kësaj edhe kërcënimin ndaj jobesimtarëve me zjarrin e xhehennemit.
- Surja El Kalem tregon gjerësisht për edukatën dhe mirësjelljen, lavdërohet Pejgamberi sal-l-Allahu alejhi ve sel-lem për moralin e lartë që posedon, sqarohet shembulli i moralit të keq të njërit nga prijësit e mosbesimit, pastaj përmendet tregimi i banorëve të kopshtit i cili është argument për humbjen e thellë të koprracëve, pastaj debatohen politeistët.
- Surja El Hakkah përshkruan trishtimet e Ditës së Kiametit, pastaj sqaron ngjarjen e fluturimit të fletëve në atë ditë, pastaj vërteton se shpallja me të cilën erdhi i Dërguari është e vërtetë.

- Surja El Mearixh shfaq disa nga trishtimet e Dittës së Kiametit, e ku janë ata që meditojnë? Më pas lavdëron disa njerëz duke përmendur edhe cilësitë e tyre, andaj medito për ato cilësi.
- Surja Nuh përshkruan thirrjen e Nuhut alejhi selam dhe mundin e tij për llojlojshmërinë e formave të thirrjes me gjithë refuzimin e madh të popullit të tij. Në mes të tjerash theksohen frytet e kërkimit të faljes si dhe kujdesi për t'u lutur për prindërit.
- Surja El Xhinn flet për mënyrën e pranimit të Islamit nga ana e xhinnëve dhe se në mesin e tyre ka muslimanë dhe jobesimtarë, pastaj kërcënohen politeistët si dhe refuzohet magia dhe pretendimi i njohjes së të fshehtës (gajbit).
- Surja El Muzemmil sqaron se adhurimi me durim është ndihma më e madhe për të përballuar

vështirësitë si dhe nxit për veprimin e disa adhurimeve.

- Surja El Muddethir nxit për të thirrur për tek Allahu, përmend një shembull nga përgënjeshtresit e Kur'anit, përshkruhet Sekari pastaj akuzohen politeistët që ia kanë kthyer shpinën Kur'anit.
- Surja El Kijame përshkruan Ditën e Kiametit, çfarë i paraprin dhe çfarë ndodh pas saj. Por, çfarë ke përgatitur për atë ditë?!
- Surja El Insan përshkruan me pak fjalë dënimin që përjetojnë jobesimtarët dhe dhuntitë që i presin besimtarët.
- Surja El Murselat flet për vërtetësinë e ringjalljes dhe shpërblimit dhe në të është përsëritur disa herë fjalia “Mjerë për përgënjeshtresit”, andaj ji i kujdesshëm!

Xhuzi i tridhjetë

- Në këtë xhuz flitet për ngjarjen e kiametit në shumë sure; medito për shembull për suren En-Nebe', për ajetet e fundit nga surja En-Naziat dhe Abese, për suret Et-Tekvir dhe El Infitar.
- Po ashtu flitet shumë për moralin e mirë dhe moralin e keq, ndaj medito mirë për këto sure.
- Ky xhuz flet qartazi për Kur'anin dhe se ai është i drejtë dhe i vërtetë, por me forma dhe mënyra të ndryshme, për shembull medito për ajetet e fundit të sures Et-Tekvir.
- Në këtë xhuz vërehet betimi i shumtë në disa krijesa të veçanta, po në këtë xhuz gjendet betimi më i shpeshtë në Kur'an, i cili është në suren Esh-Shems (njëmbëdhjetë betime), ndaj medito për fshehtësinë e betimit të Allahut për këto krijesa dhe shiko se për çka është betuar Ai.

- Në këtë xhuz gjenden disa tregime të popujve të mëhershëm, të cilat janë përmendur edhe më herët, përveç tregimit të njerëzve të hendekut.
- Bëhet thirrje për të menduar rreth jetës dhe përfundimit të krijesave, e cila në të njëjtën kohë na përudh të shtojmë punët e mira dhe të pasojmë të vërtetën.
- Në këtë xhuz gjendet surja e parë e zbritur në Kur'an, që është surja El Alek, e cila fillon me fjalën "lexo". E gjëja më e rëndësishme për t'u lexuar është libri i Allahut.
- Ky xhuz përfundon me dy sure të cilat janë edukim për ne se si duhet të lidhemi me Zotin tonë dhe të lëmë çdokënd tjetër pos Tij.
- Allahu i Lartësuar e di më së miri.

- Paqja dhe përshëndetjet qofshin mbi Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, mbi familjen e tij dhe mbi të gjithë shokët e tij.

Titulli i origjinalit

هدايات الأجزاء

Komisioni Shkencor pranë

Organit Botëror për Meditimin e Kur'anit Fisnik

“Tedebbur-Meditim”

Nën përkujdesjen dhe mbikëqyrjen e

Dr. Umer MUKBIL

Përshtati:

Xheladin LEKA

Lektor:

Mr. Arjan KOÇI

Përgatiti për shtyp:

Bashkim Avdiu

Shtypi:

Focus Print

Shkup-Prishtinë

Botues:

ESSEBIL

Tirazhi:

1000 ekz